



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.507/2019

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevi kryesues, Zyhdi Haziri dhe Ferki Xhaferi anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Vlerona Maliqi, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, e paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë, për shkak të mos procedimit për verifikim dhe numërim të 392 pakove me fletëvotime të votuesve jashtë Kosovës, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës, të datës 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me datë 24.11.2019, mori këtë:

## V E N D I M

**HUDHET** e palejueshme ankesa Anr. 507/2019 i datës 22.11.2019, e paraqitur nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, me të cilin ka kërkuar që të urdhërohet Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me seli në Prishtinë, që të bëjë verifikimin dhe numërimin e 392, pakove me fletëvotime të dorëzuara me postë nga votuesit jashtë Kosovës.

## A r s y e t i m

Lëvizja Vetëvendosje, me datë 22.11.2019, ka paraqitur në PZAP, një ankesë me të cilin ka theksuar se më datë 22.11.2019, rreth orës 13:00, në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve, janë njoftuar nga vëzhguesit e Lëvizjes Vetëvendosje, se në fahun postar Nr. 6 të KQZ-së, kanë arritur më herët 392 pako me fletëvotime, të dorëzuara me postë nga data 19 shtator 2019 deri me datë 30 shtator 2019. Paraqitësi i ankesës më tej thekson se pasi këto 392 pako me fletëvotime, janë dorëzuar në postë brenda afatit ligjor nga votuesit jashtë Kosovës, si dhe duke u mbështetur në udhëzimet e dala nga aktgjykimet e Gjykatës Supreme të Kosovës, A.A.U.ZH.nr.20/2019 i datës 30.10.2019 dhe A.A.U.ZH.nr.21/2019 i datës 05.11.2019, kërkon nga PZAP-i, që të urdhërojë KQZ-në, që të bëjë verifikimin dhe numërimin e këtyre pakove me fletëvotime.

KQZ-ja, nëpërmes përgjigjes në ankesë ka theksuar se 5 (pesë) ditë, pas shpalljes së rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve, me datë 12.11.2019, kanë shkuar për ta mbyllur fahun postar numër 6, duke konsideruar se është përmbyllur tashmë procesi zgjedhor (pas përmbylljes së procesit zgjedhor vjen faza e shkatërrimit të materialit zgjedhor), KQZ-ja ka tërhequr edhe 381 zarfe të supozuara me fletëvotime, të dërguara nga votuesit jashtë Kosovës. KQZ-së, mëtej thekson se pas mbylljes së fahut, dërgesat kanë vazhduar të arrijnë në KQZ dhe kështu në periudhën 19.11.2019 - 21.11.2019, kanë arritur në zyrën e shërbimit votuesve edhe 11 zarfe të supozuara me fletëvotime. Me propozim për panelin që ankesa të refuzohet.

Paneli, pas shqyrtimit të lejueshmërisë së ankesës, në këtë fazë të procesit zgjedhor, gjeti se, **Ankesa është e palejuar**, për këto arsye:

Paneli, vlerëson së në këtë fazë të procesit zgjedhor kur është dorëzuar ankesa në PZAP, me pretendime nga ankuesi, që të urdhërohet KQZ-ja, që të bëjë verifikimin dhe numërimin e 392, pakove me fletëvotime të dorëzuara me postë nga votuesit jashtë Kosovës, nuk mund të procedohet si ankesë e lejueshme, sepse në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, i LZP-së, i ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-256, përcaktohet se: *“Ankesat lidhur me administrimin e numërimit në QNR dorëzohen me shkrim pranë PZAP-it brenda njëzetekatër (24) orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar”*, nga kjo rezulton se në këtë fazë të procesit zgjedhor që ndodhemi, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare nga KQZ-ja, me datë 07.11.2019, mund të parashtrohen ankesa në PZAP, vetëm për administrimin në QNR. Me asnjë dispozitë ligjore të LZP-së, e me asnjë Rregull Zgjedhore, nuk parashihet mundësia që të konsiderohet e lejueshme një ankesë, që ka të bëjë me pakot e fletëvotimeve nga votuesit jashtë Kosove, të cilat pako të supozuara me fletëvotime, jo që nuk janë verifikuar dhe numëruar nga KQZ-ja, para rezultatit përfundimtar, por të njëjtat janë pranuar nga KQZ-ja, 5 ditë, pas publikimit të rezultatit përfundimtar.

Paneli, vlerëson po ashtu që edhe nëse i referohemi nenit 106 paragrafi 1, të LZP-së, i ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-256, në të cilin përcaktohet se: *“KQZ-ja certifikon rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve, pas përfundimit të të gjitha procedurave në vendvotime dhe qendrat e numërimit si dhe kur të gjitha ankesat që u përkasin votimit dhe numërimit të vendosura nga PZAP-i dhe çdo apel ndaj vendimeve të PZAP-it lidhur me to të jetë vendosur nga Gjykata Supreme e Kosovës”*, nga kjo del se mund të paraqitet ankesa në PZAP vetëm ndaj publikimit të rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve që i publikon KQZ-ja, pas përfundimit të të gjitha procedurave. Por nuk mund të jetë një ankesë e lejueshme në këtë fazë të procesit zgjedhor për një çështje që nuk ka ekzistuar apo për fletëvotime që nuk janë përfshirë me rastin e shpalljes së rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve nga KQZ-ja, me datë 07.11.2019, sepse pakot me fletëvotime që janë objekt lëndor janë pranuar nga KQZ-ja, me datë 12.11.2019, që rezulton te jetë 5 ditë pas shpalljes së rezultateve përfundimtarë, sepse nuk mund të ketë dy herë radhazi publikim të rezultatit përfundimtar nga KQZ-ja, në një proces zgjedhor.

Vetë fakti se këto pako me fletëvotime nuk janë përfshirë në rezultatin përfundimtarë të zgjedhjeve të shpallur nga KQZ-ja me datë 07.11.2019, dhe kundër këtij rezultati përfundimtarë të zgjedhjeve nuk është ushtruar ankesë për mos përfshirjen të këtyre 392 pakove me fletëvotime në atë rezultat, brenda afatit ligjor prej 24 orë, afat ky i përcaktuar me ligj për të ushtruar ankesë, çdo ankesë e ushtruar pas këtij afati konsiderohet e pas afatshme, dhe si e tillë është e pa lejueshme ngase me shpalljen e rezultatit përfundimtar përmbillet në tersi procesi zgjedhor sa i përket administrimit nga KQZ-ja.

Pretendimet e ankuesit se me aktgjykimet e Gjykatës Supreme të Kosovës, A-A.U.ZH.nr.20/2019 i datës 30.10.2019 dhe A.A-U.ZH.nr.21/2019 i datës 05.11.2019, është krijuar precedent për numërim të çdo fletëvotimi të dorëzuar me postë nga qytetarët të cilët jetojnë jashtë Kosovës, brenda afatit ligjor të publikuar nga KQZ-ja, janë të pa pranueshme kjo për faktin se paneli vlerëson se aktgjykimet e lartcekura të marra nga Gjykata Supreme e Kosovës, janë marr në një fazë tjetër të procesit zgjedhor, që ka qenë para shpalljes së rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve nga KQZ-ja, të publikuar me datë 07.11.2019, në të cilat

aktgjykime janë konstatimet në fazën e procesit zgjedhor që ishte procesi i zgjedhjeve para shpalljes së rezultatit të zgjedhjeve nuk e tangon procesin e rinumërimit, ndërsa tani jemi në një fazë krejt tjetër të procesit zgjedhor, pas shpalljes së rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve nga KQZ-ja, prandaj aktgjykimet e lart cituara në asnjë rrethanë nuk mund të jenë precedent për këtë fazë të procesit zgjedhor.

Nga arsyet e theksuar me lart, e në kuptim të nenit 6 par.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
Anr.507/2019 më datë 24.11.2019

**Kryesues i Panelit**  
**Adnan Konushevi**



***Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.*